



**BECAN Project WP4**

**AL**

**Studimi i Rasteve të Arkivuara**

**Libërth Veprimesh  
për Studiuesit**

**&  
Format e Nxjerrjes së  
Informacionit**

**Shtator 2010**



Zhvilluar në kontekstin e  
Paketës së Punës 4 "**Studimi i Survejimit të Rasteve**" (CBSS)  
**Studimi Epidemiologjik Ballkanik mbi Abuzimin dhe Neglizhimin e  
Fëmijëve**" (BEANF)  
[Nr i kontratës: FP7-HEALTH-F2-2009-223478]  
*Bashkë financiar nga DG-RESEARCH*

***Redaktuar nga Grupi Grek i BEANF WP4***

***Me kontributin e:***

Enila Cenko përfaqësuese e grupit të Shqipërisë, Shqipëri  
Marina Ajduković, Jelena Ogresta, Miroslav Rajter, Nika Sušac, Lea Zorec, Kroaci  
Emir Vajzovic & Jelena Brkic Smigoc, Bosnia & Hercegovina  
Vaska Stancheva-Popkostadinova, Bulgaria  
Marija Raleva Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë  
Júlia Szigeti përfaqësuese e grupit të Rumanisë, Rumani  
Veronika Išpanović përfaqësuese e grupit të Serbisë, Serbi  
Zeynep Olmezoglu përfaqësuese e grupit të Turqisë, Turqi

**Instituti i Shëndetit Mendor**

Departmenti i Shëndetit Mendor dhe Mirëqënies Sociale  
Qendra për Studimin dhe Parandalimin e Abuzimit dhe Neglizhimit të Fëmijëve  
GREQI

## **PËRMBATJA**

<b>Hyrje</b>	<b>2</b>
<b>Përkufizimi i “rastit” – Përkufizime konceptuale dhe operacionale</b>	<b>3</b>
<b>Mjetet kërkimore</b>	<b>5</b>
<i>Struktura</i>	5
<i>Përmbledhje e variablave që do hulumtohen</i>	10
<i>Formati i formave të nxjerrjes së të dhënave</i>	13
<b>Prezantim i detajuar i variablave</b>	<b>15</b>
<b>PJESA I: Variablat në lidhje me Agjensinë &amp; Arkivin/Database</b>	<b>16</b>
<i>Informacioni mbi Agjensinë</i>	16
<i>Informacioni mbi Arkivin/database</i>	23
<b>PJESA II: Variablat në lidhje me rastin ANF</b>	<b>28</b>
<i>Identiteti i rastit</i>	28
<i>Informacion mbi fëmijën</i>	33
<i>Informacion mbi incidentin</i>	46
<i>Informacion mbi dhunuesin/en</i>	52
<i>Informacion mbi personin(at) që kujdesen për fëmijën</i>	58
<i>Informacion mbi familjen</i>	62
<i>Informacion mbi gjendjen familjare</i>	64
<i>Informacion mbi keqtrajtme të mëparshme</i>	66
<i>Informacion mbi ndjekjen e rastit</i>	67
<b>Kodimi i të dhënave</b>	<b>68</b>

## **ANEKSE**

### **Format e Nxjerrjes së të Dhënave**

PJESA I: Forma për Agjensitë/Arkivat

PJESA II: Forma për Rastet

## Hyrje

Ky libërth, i shkruar në kontekstin e WP4 të studimit BECAN, ju drejtohet kërkuesve që do të përfshien në studimin e azuar mbi rastet me qëllimin që t'i udhëzojë ata mbi përdorimin e formave për nxjerrjen e të dhënave mbi ANF nga dokumente ekzistues që ndodhen në agjensi dhe shërbime të ndryshme sociale, shëndetësore, ligjore, dhe policie.

Së pari, ky dokument përmban përkufizimet konceptuale dhe operacionale të termave kryesorë – më konkretisht të ANF dhe formave të ndryshme. Është e pritshme që të dhënat ekzistuese do të ndryshojnë nga njëra-tjetra në varësi të sektorit nga i cili vijnë. Përkufizimet konceptuale dhe operacionale synojnë të ndihmojnë kërkuesit në lokalizimin e rasteve të ANF në arkivat dhe database ekzistuese. Së dyti, do të prezantohet struktura e mjeteve kërkimore si dhe një përmbledhje e variablave të përfshira në protokollin e studimit dhe të karakteristikave të të dy formave të nxjerrjes së informacionit, si të asaj për agjensitë dhe të asaj për rastet e ANF. Së fundmi, do të paraqitet një prezantim i detajuar i karakteristikave të çdo variable individuale.

Ky libërth udhëzimesh do të përdoret si gjatë seancës së trajnimit të trajnuesve ashtu dhe në atë të kërkuesve, siç përshkruhet në "Protokollin për Nxjerrjen e Informacionit mbi ANF nga Arkivat/Database. Së bashku me udhëzuesin, çdo grup kërkimor kombëtar do të marrë a. listën e agjensive pjesëmarrëse në studim dhe kontaktet e tyre së bashku me personat e kontaktit dhe b. tabelën treguese të kohëzgjatjes së studimit ku grupet kërkimore do të punojnë për nxjerrjen e të dhënave në agjensi.

Duhet vënë në dukje që të *gjitha* format e rasteve të identifikuara të ANF (abuzim fizik, seksual dhe psikologjik si dhe neglizhim) do të përfshihen në studim sipas përkufizimeve konceptuale dhe operacionale të paraqitura më poshtë, pavarësisht nëse janë të vërtetuara ose jo.

## Përkufizimi i "rastit"- Përkufizime operacionale

Shumica e arkivave/database që do përdoren si "burime të dhënash" për BEANF CBSS nuk merren vetëm me raste ANF. Për këtë arsye, kërkuesit në çdo vend duhet të identifikojnë rastet e ANF dhe të vendosin përkatësisht si duhet të realizohet regjistrimi për qëllimet e studimit. Përkufizimet konceptuale, ama, mund të mos japin detaje të mjaftueshme që kërkuesit të vendosin nëse një regjistrim i caktuar në database/arkiv lidhet me ANF ose jo. Për të lehtësuar këtë proces, janë zhvilluar një sërë përkufizimesh operacionale që do të ndihmojnë kërkuesit të specifikojnë çfarë duhet të kërkojnë gjatë hulumtimit të një database apo arkivi. Kjo nuk do të thotë, sidoqoftë, që përkufizimet e dhëna operacionale janë gjithëpërfshirëse; ato janë një mjet që synon të vendosë një metodologji të përbashkët për mbledhjen e të dhënave.

Në tabelën e mëposhtme, ngjitur me *përkufizimet konceptuale* të vendosura nga OBSH dhe ISPANF (2006), paraqiten përkufizimet operacionale që do të përdoren në kontekstin e BECAN CBSS. Jemi përpjekur që këto përkufizime të jenë sensitive (domethenë t'ju japin kërkuesve aftësinë për të identifikuar një proporcion të lartë të rasteve me ANF), specifike (të udhëheqin kërkuesit që të shmangin përfshirjen e rasteve të rreme pozitive), të thjeshta, të kuptueshme dhe plotësisht të qarta për t'u aplikuar.

Përkufizimet konceptuale (OBSh & ISPCAN, 2006)	Përkufizimet Operacionale për BEANF CBSS
<p><b>Abuzimi fizik:</b> Abuzimi fizik i fëmijëve përkufizohet si përdorimi i qëllimshëm i forcës fizike kundër fëmijës dhe që rezultojnë në – ose ka shumë mundësi të rezultojnë në – dëmtim të shëndetit, mbijetesës, zhvillimit dhe dinjitetit të fëmijës. Ai përfshin gjuajtje, rrahje, shkelmim, shkundje, kafshim, mbytje, djegie, helmim dhe marrje fryme. Në shumë raste dhuna fizike ndaj fëmijëve në shtëpi ushtrohet me qëllim ndëshkimi.</p>	<p><b>Abuzimi fizik:</b> Një rast "abuzimi fizik" mund të konsiderohet çdo regjistrim që përshkruan një incident me informacion mbi të paktën dy elementë, veprim dhe pasojë: një <b>veprim</b> nga ana e një personi [dhunuesi (i prezumuar)] që ka një <b>pasojë</b> mbi fëmijën. Aktet e abuzimit fizik (gjuajtje, rrahje etj. Shih dhe variablën C7), pavarësisht qëllimit, rezultojnë në lëndim fizik joaksidental të viktimës-fëmijë, duke përfshirë dhe incidente të ndëshkimit fizik të rëndë. Këto pasoja mund të jenë lëndim fizik si shenja në fytyrë, djegie, fraktura, çarje dhe gërvishitje (shih dhe variablën C9). Në disa raste, përveç ose dhe në mungesë të dëmtimit të dukshëm fizik, mund të jetë adoptimi i një sjellje të caktuar nga ana e fëmijës viktimë. Sjelljet që duhen ekzaminuar si pasojë e abuzimit fizik mund të përfshijnë komente që tregojnë që fëmija ishte jo rehat me kontaktin fizik, tregon agresivitet ose tërheqje, ishte i/e frikësuar nga prindërit/kujdestarët dhe kishte frikë të kthehej në shtëpi.</p>
<p><b>Abuzimi seksual:</b> Përfshirja e një fëmije në aktivitet seksual që ai ose ajo nuk mund ta kuptojë plotësisht, është i/e paaftë të japë pëlqimin e tij/saj, ose për të cilin fëmija nuk është i/e përgatitur për shkak të nivelit të zhvillimit, ose që dhuron ligjet ose tabutë sociale të shoqërisë. Fëmijët mund të abuzohen seksualisht si nga të rriturit dhe nga fëmijë të tjerë që janë – për shkak të moshës së tyre ose për nivelin e zhvillimit – në një pozicion përgjegjegjësie, besimi ose pushtetimi viktimën.</p>	<p><b>Abuzimi seksual:</b> Një rast "abuzimi seksual" mund të konsiderohet çdo regjistrim që përshkruan një incident me të paktën një informacion mbi çështje seksuale. Vihet re se regjistrimet që përshkruajnë raste të abuzimit seksual mund të kenë përshkrime të rasteve ku <b>nuk ka prekje</b> (si ekzpozimi i gjenitaleve apo i materialeve pornografike tek fëmija) por dhe raste <b>ku ka prekje</b> (si prekje gjenitalesh) dhe <b>shfrytëzim seksual</b> (si prostituimi i fëmijës apo përdorimi i fëmijës në pornografi) (shih dhe variablën C11). Për më tepër, çdo regjistrim ekzistues i shoqëruar nga <b>dokumentim</b> si ekzaminim fizik dh/ose harta trupore nga mjekët që tregojnë abuzim seksual duhet të regjistrohen si raste të abuzimit seksual". Regjistrime që përfshijnë përshkrime të sjelljes së fëmijës, si njohuri mbi seksin që nuk përkohet me moshën dhe frikë e pashpjegueshme për një person apo vend, duhet të ekzaminohet me kujdes për të parë nëse janë raste abuzimi seksual.</p>

<p><b>Abuzimi psikologjik:</b>  Abuzimi emocional dhe psikologjik përfshin si incidente të izoluarashtu dhe dështimin e vazhdueshëm të prindërve apo kujdestarëve për të siguruar një ambient mbështetës dhe të përshtatshëm për zhvillimin e fëmijës. Abuzimi i kësaj natyre përfshin: kufizimin e lëvizjes; forma të vazhdueshmë të vënies në faj, uljes së dinjitetit, kërcënimit, frikësimit, diskriminimit, talljes, si dhe forma të tjera të mohimit apo trajtimit keqdashës.</p>	<p><b>Abuzimi psikologjik:</b> Një rast "abuzimi psikologjik" mund të konsiderohet çdo regjistrim që përfshin informacion mbi <b>mënyra specifike të sjelljes</b> si ulja e figurës së fëmijës, tallja, injorimi dhe mohimi, indiferenca ndaj problemeve të fëmijës dhe mënyra të pazakonta të disiplinimit të përdorura nga personat që kujdesen për fëmijët [si p.sh prindërit]. Për faktin se <b>ky lloj abuzimi mund të jetë dhe rezultati i dy formave të tjera të abuzimi dhe neglizhimit</b>, kërkuesit duhet të ekzaminojnë me kujdes regjistrimet që përmendin: çrregullime të të folurit, zhvillim të vonuar, zakone si thithjen e gishtit, kafshim, lëkundje, sjellje antisociale dhe shkatërruese, çrregullime të gjumit, dëshirën për të plotësuar gjithmonë kërkesat e të tjerëve, pasivitet, sjellje vetë-shkatërruese dhe tentativa për vetëvrasje, raportime nga vetë fëmija që ndjen kënaqësi kur lëndon njerëz të tjerë apo kafshë, si dhe sjellje kriminale (shih dhe variablën C13).</p>
<p><b>Neglizhimi:</b> Neglizhimi përfshin si incidente të izoluarashtu dhe dështime të vazhdueshme nga ana e prindit apo pjesëtarëve të familjes për të siguruar zhvillimin dhe mirëqënien e fëmijës— në rastin kur prindi është në gjendje t'i sigurojë ato —në një nga aspektet e mëposhtme: shëndeti, arsimimi, zhvillimi emocional, ushqimi, strehimi dhe kushte të sigurta të jetesës. Prindërit e fëmijëve të neglizhuar nuk janë detyrimisht të varfër. Ata mund të jenë dhe në gjendje të mirë ose shumë të mirë financiare.</p>	<p><b>Neglizhimi:</b> Një rast "neglizhimi" mund të konsiderohet çdo regjistrim që përshkruan një incident që përfshin informacion në lidhje me dështimin e personave që kujdesen për fëmijën që të sigurojnë nevojat bazike të fëmijës (ushqim, veshje, strehim), të mbikëqyrin fëmijën dhe të japin kujdesin e nevojshëm për shëndetin e fëmijës. Në çdo rast neglizhimi pritet që të ketë dy elementë: <b>një mosveprim</b> nga ana e kujdestarit që ka <b>një pasojë mbi fëmijën</b> (fizike, sjellore, emocionale) (shih dhe C15). Çdo regjistrim duhet të ekzaminohet nëse përfshin informacion mbi familje dhe kushte jetese kaotike, që nuk kanë rregulla apo rutina (si orare të përcaktuara të të ngrënit, të fjeturit, të bërjes së detyrave, të hapësirave të nevojshme për fëmijën) si dhe ky ka krizë (humbje e vendit të punës, sëmundje të rënda apo divorc). Gjithashtu, kërkuesit duhet të konsiderojnë rekorde ku përmendet se fëmija dukej i/e paushqyer, i/e uritur, letergjik, kishte plagë të pamjekuara, nuk ishte i/e pastër, nuk ishte veshur me veshje të përshtatshme për stinën, ku raportonte shumë aksidente, dëmtime fizike dhe sjellje të rrezikshme, abuzim substancash (alkool ose drogë) dhe vështirësi të të nxënimit.</p>

## Mjeti Kërkimor

### Struktura

Mjeti përbëhet nga dy pjesë: e para adreson çështje të lidhura me agjensitë pjesëmarrëse dhe rekordet që ato kanë mbi ANF; ndërsa e dyta adreson vetë rastet e ANF. Çdo pjesë përfshin një numër variablash të matshme, të cilat janë kategorizuar nën titujt e përgjithshëm.

#### **PJESA I**

Kjo pjesë e formës së nxjerrjes së të dhënave përmban informacion mbi agjensinë/organizatën që jep të dhënat, me qëllim hulumtimin e burimeve nga vijën e dhënave.

Kjo pjesë përfshin dy kategori të përgjithshme mbi identitetin e agjensisë dhe arkivin e saj.

Pjesa e parë e formës duhet të kompletohet vetëm një herë për çdo agjensitë që do të japë akses mbi arkivin/databasin e saj, pavarësisht numrit të rasteve që do të identifikohen dhe nga të cilat do të nxirren të dhënat. 13 variabla do të përdoren për të regjistruar të gjithë informacionin e nevojshëm për identitetin e agjensisë dhe 7 variabla do të përdoren për të marrë informacionin mbi arkivat/database të mbajtura nga agjensia. Një përmbledhje e variablave të përfshira në këtë formë është paraqitur në Tabelën 14.

#### **PJESA II**

Kjo pjesë përfshin dhjetë kategori të përgjithshme mbi identitetin e rasti, fëmijën, incidentin, dhunuesin(t), kujdestarët (kur këta janë persona të tjerë nga dhunuesit), familjen, kushtet e jetesës, historikun e keqtrajtimit të mëparshme dhe cilat agjensitë janë kontaktuar dhe çfarë shërbimesh janë dhënë për incidentin në fjalë (nëse ka).

Pjesa e dytë e formës do të kompletohet aq herë sa janë raste të identifikuara në arkivin/database për periudhën kohore të parapërcaktuar, pra nga një formë për çdo rast. Një përmbledhje e variablave të dhjetë kategorive të lartpërmendura është paraqitur në Tabelën 15.

**Tabela 14:** Përmbledhje e 21 variablave mbi identitetin e agjensisë dhe të karakteristikave të arkivit/database

Njësia	Kategoria	Variabla	Përshkrimi
a1	Agensia	<b>Kodi i identifikimit</b>	Njësia unike e identifikimit për çdo agjensi pjesëmarrëse në studim
a2	Agensia	<b>Statusi Ligjor</b>	Cili është statusi ligjor i agjensisë
a3	Agensia	<b>Statusi operativ</b>	Nëse agjensia vepron në mënyrë të pavarur në nivel kombëtar apo lokal
a4	Agensia	<b>Sektori</b>	Cilit sektor i përket agjensia
a5	Agensia	<b>Misioni</b>	Cili është misioni në të cilin është orientuar agjensia
a6	Agensia	<b>Burimet njerëzore</b>	Numri i të punësuarëve në agjensi
a7	Agensia	<b>Personeli që punon me ANF</b>	Numri i punonjësve që punon në agjensi dhe që i dedikohet veçanërisht rasteve të ANF
a8	Agensia	<b>Numri i rasteve të ANF</b>	Sa është numri mesatar i rasteve që agjensia merr në muaj
a9	Agensia	<b>Fusha</b>	Fusha në të cilën agjensia ofron shërbime për fëmijët
a10	Agensia	<b>Burimet e referimit</b>	Cilat janë burimet që referojnë raste tek agjensia
a11	Agensia	<b>Vlerësimi për AND</b>	Nëse agjensia zbaton një protokoll rutinë për të vlerësuar nëse ka abuzim në familje
a12	Agensia	<b>Trainim mbi çështjet e ANF</b>	Nëse ka një program të veçantë trajnimi mbi ANF
a13	Agensia	<b>Personeli i trajnuar</b>	Numri i punonjësve të trajnuar mbi çështjet e ANF
a14	Agensia	<b>Statistika</b>	Pasja e të dhënave statistikore mbi ANF
b1	Arkiv	<b>Periudha kohore e mbuluar</b>	Cila është koha totale e mbuluar nga arkiva/database e agjensisë
b2	Arkiv	<b>Lloji i regjistrimit</b>	Cili është formati i arkivit/database
b3	Arkiv	<b>Forma e regjistrimit</b>	Nëse ka një formë të veçantë për regjistrimin e ANF DHE që përdoret në agjensi
b4	Arkiv	<b>Përmbajtja e arkivit/database</b>	Cilat lloje të rasteve janë përfshirë në arkivin/database e agjensisë
b5	Arkiv	<b>Personeli që regjistron rastet</b>	Cili është profesioni i stafit që regjistron rastin
b6	Arkiv	<b>Dokumentim i mëtejshëm</b>	Nëse ka dokumentim të mëtejshëm që shoqëron regjistrimin
b7	Arkiv	<b>Dokumentim me shkrim</b>	Nëse rasti i keqtrajtimit është i shoqëruar me tekst të shkruar



**Tabela 15:** Përmbledhje e 82 variablave mbi dhjetë kategoritë e përgjithshme për informacionin e regjistruar për çdo rast

Njësia	Kategoria	Variabla	Përshkrimi
A1	Rasti	<b>Kodi i identifikimit</b>	Njësia unike e identifikimit që i vihet një rasti
A2	Rasti	<b>Kodi i identifikimit të fëmijës</b>	Njësia unike e identifikimit që i vihet fëmijës
A3	Rasti	<b>Data e raportit</b>	Data kur rasti ka arritur në agjensi dhe është regjistruar keqtrajtimi
A4	Rasti	<b>Data e rekordit</b>	Data kur rasti regjistrohet nga kërkuesi në formën e BEANF
B1	Fëmija	<b>Mosha e fëmijës</b>	Mosha e fëmijës në kohën kur është shkruar raporti (në vite)
B2	Fëmija	<b>Seksi i fëmijës</b>	Seksi i fëmijës
B3	Fëmija	<b>Kombësia</b>	Kombësia e fëmijës dhe grupi etnik (nëse aplikohet)
B4	Fëmija	<b>Niveli i arsimit</b>	Niveli i arsimit të fëmijës
B5	Fëmija	<b>Punësimi</b>	Punësimi i fëmijës
B6	Fëmija	<b>Probleme me shkollën</b>	Probleme të raportuara të fëmijës në lidhje me të nxënit dhe ambientin e shkollës
B7	Fëmija	<b>Probleme të sjelljes</b>	Probleme të raportuara të sjelljes së fëmijës
B8	Fëmija	<b>Abuzim substancash</b>	Probleme të raportuara të fëmijës në lidhje me abuzimin e substancave
B9	Fëmija	<b>Gjendja shëndetësore e fëmijës</b>	Çrregullime të diagnostikuara fizike, mendore ose të zhvillimit të fëmijës
B10	Fëmija	<b>Numri i telefonit</b>	Nëse ka një numër telefoni të fëmijës në raport
B11	Fëmija	<b>Adresa</b>	Nëse ka një adresë të fëmijës në raport
C1	Incidenti	<b>Data e incidentit</b>	Data kur ka ndodhur incidenti
C2	Incidenti	<b>Kohëzgjatja e keqtrajtimit</b>	Sqarim nëse keqtrajtimi ka ndodhur një herë apo disa herë dhe kohëzgjatja e tij
C3	Incidenti	<b>Burimi i referimit</b>	Cili është burimi nga është referuar rasti për incidentin në fjalë
C4	Incidenti	<b>Vendndodhja e incidentit</b>	Vendi ku ka ndodhur incidenti (një ose disa herë si pash neglizhimi, abuzimi seksual)
C5	Incidenti	<b>Forma e keqtrajtimit</b>	Forma e keqtrajtimit
C6	Incidenti	<b>Statusi i abuzimit fizik</b>	Rezultatet e investigimit mbi ANF që shoqërojnë raportimin e abuzimit fizik
C7	Incidenti	<b>Format e abuzimit fizik</b>	Specifikimi i formave të raportuara të abuzimit fizik
C8	Incidenti	<b>Plagosje nga abuzimi fizik</b>	Ekzistenca dhe vlerësimi i nivelit të dëmtimit fizik si pasojë e abuzimit fizik
C9	Incidenti	<b>Natura e plagosjes</b>	Lloji i dëmtimit fizik që ka pësuar apo vuajtur fëmija
C10	Incidenti	<b>Statusi i abuzimit seksual</b>	Rezultatet e investigimit mbi raportimin e abuzimit seksual të dyshuar
C11	Incidenti	<b>Format e abuzimit seksual</b>	Specifikimi i formave të raportuar të abuzimit seksual
C12	Incidenti	<b>Statusi i abuzimit psikologjik</b>	Rezultatet e investigimit mbi raportimin e abuzimit psikologjik/emocional të dyshuar
C13	Incidenti	<b>Format e abuzimit psikologjik</b>	Specifikimi i formave të abuzimit psikologjik të raportuar
C14	Incidenti	<b>Statusi i neglizhimit</b>	Rezultatet e investigimit mbi raportimin e neglizhimit të dyshuar

C15	Incidenti	<b>Format e neglizhimit</b>	Specifikimi i formave të neglizhimit të raportuar
C16	Incidenti	<b>Vlerësimi i akuzës së ANF</b>	Vlerësimi i akuzës për ANF bazuar mbi informacion/fakte të ardhura nga një ose disa burime
C17	Incidenti	<b>Konfirmimi i keqtrajtimit</b>	Konfirmim i regjistruar që keqtrajtimi ka ndodhur
C18	Incidenti	<b>Hapat ligjorë të ndërmarrë</b>	Hapat ligjorë të ndërmarrë mbas regjistrimit të ANF
C19	Incidenti	<b>Plani i kujdesit</b>	Plani i kujdesit për fëmijën
C20	Incidenti	<b>Sistemimi jashtë shtëpisë</b>	Nëse fëmija do qëndrojë në shtëpi apo do largohet prej saj
D1	Dhunuesi(t)	<b>Numri i dhunuesve</b>	Sa dhunues kanë qenë të përfshirë
D2	Dhunuesi(t)	<b>Dhunuesi /Dhunuesi i pretenduar</b>	Vendimi për dhunuesin pas hetimit gjyqësor
D3	Dhunuesi(t)	<b>Seksi</b>	Seksi i dhunuesit
D4	Dhunuesi(t)	<b>Mosha</b>	Mosha e dhunuesit në kohën kur është bërë raporti, në vite
D5	Dhunuesi(t)	<b>Kombësia</b>	Kombësia e dhunuesit dhe grupi etnik
D6	Dhunuesi(t)	<b>Niveli i arsimit</b>	Niveli i arsimit të dhunuesit
D7	Dhunuesi(t)	<b>Punësimi</b>	Punësimi i dhunuesit
D8	Dhunuesi(t)	<b>Statusi civil</b>	Gjendja civile e dhunuesit
D9	Dhunuesi(t)	<b>Lidhja me fëmijën</b>	Lidhja e dhunuesit me fëmijën-viktimë
D10	Dhunuesi(t)	<b>Abuzim substancash</b>	Problemet e raportuara të dhunuesit në lidhje abuzimin e substancave narkotike
D11	Dhunuesi(t)	<b>Çrregullime fizike/mendore</b>	Çrregullime të diagnostikuara fizike ose mendore të dhunuesit
D12	Dhunuesi(t)	<b>Histori abuzimi</b>	Raportim i abuzimit të vetë dhunuesit gjatë fëmijërisë ose në moshë të rritur
D13	Dhunuesi(t)	<b>Abuzime të mëparshme</b>	Akuza të mëparshme për abuzim për dhunuesin
D14	Dhunuesi(t)	<b>Numri i telefonit</b>	Nëse ka një numër telefoni të dhunuesit në raport
D15	Dhunuesi(t)	<b>Adresa</b>	Nëse ka një adresë të dhunuesit në raport
E1	Kujdestari (ët)	<b>Kujdestari dhe dhunuesi</b>	Nëse dhunuesi(t) është/janë person(a) i/të ndryshëm nga dhunuesi(t)
E2	Kujdestari (ët)	<b>Numri</b>	Sa persona kujdesen për fëmijën
E3	Kujdestari (ët)	<b>Lidhja me fëmijën</b>	Lidhja e kujdestarit me fëmijën-viktimë
E4	Kujdestari (ët)	<b>Lloji i kujdestarisë</b>	Cili është lloji i kujdestarisë
E5	Kujdestari (ët)	<b>Seksi</b>	Seksi i kujdestarit
E6	Kujdestari (ët)	<b>Mosha</b>	Mosha e kujdestarit në kohën kur është shkruar raporti (në vite)
E7	Kujdestari (ët)	<b>Kombësia</b>	Kombësia e kujdestarit dhe grupi etnik
E8	Kujdestari (ët)	<b>Niveli i arsimit</b>	Niveli i arsimit i kujdestarit
E9	Kujdestari (ët)	<b>Punësimi</b>	Punësimi i kujdestarit
E10	Kujdestari (ët)	<b>Statusi civil</b>	Gjendja civile e kujdestarit
E11	Kujdestari (ët)	<b>Abuzim substancash</b>	Probleme të raportuara të kujdestarit në lidhje me abuzimin e substancave

E12	Kujdestari (ët)	<b>Çrregullime fizike/mendore</b>	Çrregullime të diagnostikuara fizike ose mendore të kujdestarit
E13	Kujdestari (ët)	<b>Histori abuzimi</b>	Nëse dihet apo dyshohet që kujdestari ka qënë vetë i abuzuar
E14	Kujdestari (ët)	<b>Abuzime të mëparshme</b>	Akuza të mëparshme për abuzim për kujdestarin
E15	Kujdestari (ët)	<b>Numri i telefonit</b>	Nëse ka një numër telefoni të kujdestarit në raport
E16	Kujdestari (ët)	<b>Adresa</b>	Nëse ka një adresë të kujdestarit në raport
F1	Familja	<b>Gjendja e familjes</b>	Gjendja e familjes në të cilën jeton fëmija në kohën kur është shkruar raporti
F2	Familja	<b>Numri i bashkëjetuesve</b>	Numri i personave që jetojnë në shtëpi përveç fëmijës-viktimë (përfshirë nënën/babain/kujdestarët)
F3	Familja	<b>Identiteti i bashkëjetuesve</b>	Identiteti i personave që jetojnë në shtëpi përveç fëmijës-viktimë
F4	Familja	<b>Viktima të tjera të ANF</b>	Incidente të ANF që i kanë ndodhur një fëmije tjetër në familje
F5	Familja	<b>Forma të tjera abuzimi</b>	Incidente të dhunshme që i kanë ndodhur një të rrituri në familje
F6	Familja	<b>Referim në shërbime</b>	Referime në shërbime të tjera për fëmijën dhe familjen
F7	Familja	<b>Shërbimet e marra</b>	Shërbimet e marra që kanë në qendër fëmijën dhe familjen (të tanishme ose të mëparshme)
G1	Shtëpia	<b>Përshtatshmëria e strehimit</b>	Nëse fëmija dhe familja jetojnë në kushte të papërshtatshme
G2	Shtëpia	<b>Të ardhurat familjare</b>	Të ardhurat e raportuara familjare
G3	Shtëpia	<b>Burimi i të ardhurave</b>	Burimi kryesor i të ardhurave në familje
G4	Shtëpia	<b>Probleme financiare</b>	Financat familjare nuk mbulojnë nevojat minimale
H1	Keqtrajtimi i mëparshëm	<b>Keqtrajtimit i mëparshëm</b>	I referohet incidenteve të keqtrajtimit të mëparshëm
H2	Keqtrajtimi i mëparshëm	<b>Lloji</b>	Lloji më i rëndë i keqtrajtimit të mëparshëm, i vërtetuar ose jo
H3	Keqtrajtimi i mëparshëm	<b>Dhunuesi (t)</b>	Dhunuesi(t) që kanë ushtruar llojin më të rëndë të keqtrajtimit të mëparshëm
H4	Keqtrajtimi i mëparshëm	<b>Agjensitë investiguese</b>	Agjensitë e përfshira dhe që kanë dhënë shërbime gjatë investigimit të incidentit të keqtrajtimit më të rëndë
I1	Ndjekja e rastit	<b>Ndjekja e rastit</b>	Nëse ka informacion për ecurinë/ndjekjen e rastit në agjensi

## Përmbledhje e variablave që do të investigohen

Në bazë të argumentimit të përshkruar në Udhëzimet e Survejimit të Lëndimit Fizik të përgatitura nga OBSH,<sup>1</sup> variablat e përfshira në mjetin kërkimor nën kategoritë e përgjithshme do të paraqiten në një mënyrë të përbashkët dhe të strukturuar.

Tabela e mëposhtme tregon mënyrën në të cilën çdo pjesë e informacionit është përkufizuar dhe si do të kodohet. Në kolonën e parë jepet informacioni për çdo variabël; në kolonën e dytë, jepet një përshkrim i informacionit.

**Tabela 16: Karakteristikat e paraqitura për çdo variabël**

<b>Informacioni</b>	<b>Përshkrimi</b>																										
Njësia	Shkurtimi i variablës të bazuar në kategorinë përkatëse dhe kodi unik i identifikimit																										
Variabla	Emri i variablës Gjithsej do të përfshihen në protokoll 104 variabla (22 në formën për agjensitë dhe 82 në formën për rastet)																										
Përkufizimi Kategoria	Një përshkrim i shkurtër që shpjegon çfarë synon të masë çdo variabël Tregon kategorinë e përgjithshme në lidhje me ANF. Gjithsej janë 11 kategori ku secila ka disa variabla. Këto kategori janë:  <b>Forma e Nxjerrjes së Informacionit për Agjensinë/Arkivin (Pjesa I):</b> Të plotësohet një herë për çdo agjensi nga do nxirren të dhënat (pavarësisht numrit të rasteve që do nxirren nga agjensia) <table border="1" data-bbox="487 997 1055 1102"> <thead> <tr> <th><b>Kategoria</b></th> <th><b>Variablat</b></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>a. Agjensia</td> <td>a.1-a.15</td> </tr> <tr> <td>b. Arkiva</td> <td>b.1-b.7</td> </tr> </tbody> </table> <b>Forma e Nxjerrjes së të Dhënave për Rastet (Pjesa II):</b> Të plotësohet për çdo rast individual <table border="1" data-bbox="487 1186 1055 1501"> <thead> <tr> <th><b>Kategoria</b></th> <th><b>Variablat</b></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A. Identifikimi i rastit</td> <td>A1-A4</td> </tr> <tr> <td>B. Informacion mbi fëmijën</td> <td>B1-B11</td> </tr> <tr> <td>C. Informacion mbi incidentin</td> <td>C1-C20</td> </tr> <tr> <td>D. Informacion mbi dhunuesin(t)</td> <td>D1-D15</td> </tr> <tr> <td>E. Informacion mbi kujdestarin</td> <td>E1-E16</td> </tr> <tr> <td>F. Informacion mbi familjen</td> <td>F1-F7</td> </tr> <tr> <td>G. Informacion mbi familjen</td> <td>G1-G4</td> </tr> <tr> <td>H. Keqtrajtme të mëparshme</td> <td>H1-H4</td> </tr> <tr> <td>I. Ndjekja e rastit</td> <td>I1</td> </tr> </tbody> </table>	<b>Kategoria</b>	<b>Variablat</b>	a. Agjensia	a.1-a.15	b. Arkiva	b.1-b.7	<b>Kategoria</b>	<b>Variablat</b>	A. Identifikimi i rastit	A1-A4	B. Informacion mbi fëmijën	B1-B11	C. Informacion mbi incidentin	C1-C20	D. Informacion mbi dhunuesin(t)	D1-D15	E. Informacion mbi kujdestarin	E1-E16	F. Informacion mbi familjen	F1-F7	G. Informacion mbi familjen	G1-G4	H. Keqtrajtme të mëparshme	H1-H4	I. Ndjekja e rastit	I1
<b>Kategoria</b>	<b>Variablat</b>																										
a. Agjensia	a.1-a.15																										
b. Arkiva	b.1-b.7																										
<b>Kategoria</b>	<b>Variablat</b>																										
A. Identifikimi i rastit	A1-A4																										
B. Informacion mbi fëmijën	B1-B11																										
C. Informacion mbi incidentin	C1-C20																										
D. Informacion mbi dhunuesin(t)	D1-D15																										
E. Informacion mbi kujdestarin	E1-E16																										
F. Informacion mbi familjen	F1-F7																										
G. Informacion mbi familjen	G1-G4																										
H. Keqtrajtme të mëparshme	H1-H4																										
I. Ndjekja e rastit	I1																										
Plotësimi	Kjo fushë tregon nëse plotësimi i variablës është i detyrueshëm apo i kushtëzuar, pra nëse variabla në fjalë është e domosdoshme për eksplorimin e kategorisë (plotësim i detyrueshëm), apo i kushtëzuar (në varësi të përgjigjeve mbi variablën e mëparshme). Nga 82 variablat e përfshira në protokoll për rastet e ANF, 54 janë të detyrueshme dhe 28 janë të kushtëzuara (shih tabelën e mëposhtme); për kategorinë e agjensisë 14 variabla janë të detyrueshme 14 dhe 1 e kushtëzuar; për kategorinë e arkivit të shtata variablatë janë të detyrueshme.																										

<sup>1</sup> Holder, Y., Peden, M., Krug, E. et al (Eds). (2001). Injury surveillance guidelines. Geneva, World Health Organization.

Kategoritë e targetuara	Variablat në total	Të detyrueshme	Të kushtëzuara (filtër)
I. Agjensia	15	14	1
II. Arkiva	7	7	0
<b>PJESA 1-Total</b>	<b>22</b>	<b>21</b>	<b>1</b>
A. Identifikimi i rastit	4	4	0
B. Informacion mbi fëmijën	11	11	0
C. Informacion mbi incidentin	20	10	10
D. Informacion mbi dhunuesin (t)	15	15	0
E. Informacion mbi kujdestarin	16	1	15
F. Informacion mbi familjen	7	7	0
G. Informim mbi shtëpinë	4	4	0
H. Keqtrajtme të mëparshme	4	1	3
I. Ndjekja e rastit	1	1	0
<b>PJESA 2-Totali</b>	<b>82</b>	<b>54</b>	<b>28</b>
<b>Totali (Pjesa I &amp; II)</b>	<b>104</b>	<b>75</b>	<b>29</b>

Kodimi Tregon nëse kodi i variablës është numerik apo me fjalë; kodet numerike janë më të preferuara se ato me fjalë, pasi ndihmojnë në procesin e nxjerrjes së të dhënave

Kodimi: | Numerike 92  
Me fjalë 12

**Variablat në total** | 104

Niveli matës Niveli matës i variablës (shkallë, ordinal, nominal)

Niveli matës: | Shkallë 9  
Ordinal 3  
Nominal 92

**Variablat në total** | 104

Vlerat e kodeve Tregojnë vlerat e mundshme që mund të ketë një variabël. Një përshkrim është dhënë për çdo variabël individuale që është në listën vlerave të mundshme të variablave të parakoduara. (p.sh. 0=Jo, 1=Po, etj.)

Një sërë sistemesh kodimi dhe protokolle janë konsultuar për krijimin e listës së variablave dhe të vlerave të tyre të mundshme:

- Udhëzuesi mbi survejimin e dëmtimit fizik i publikuar nga OSH (2001),<sup>2</sup>
- Guida e Libri i Kodeve për Përdoruesit e Sistemit Kombëtar për të Dhënat mbi Abuzimin dhe Neglizhimin e Fëmijëve (NANFDS) i publikuar nga Arkiva e të Dhënave Kombëtare mbi Abuzimin dhe Neglizhimin e Fëmijëve në bashkëpunim me Walter R. McDonald & Associates në 2003,<sup>3</sup>
- Klasifikimi Ndërkombëtar i Shkaqeve të Jashtme të Plagosjeve (ICECI) përgatitur nga Grupi Koordinues dhe Mirëmbajtës ICECI në 2004,<sup>4</sup>
- Udhëzime mbi mbledhjen dhe monitorimin e të dhënave mbi abuzimin e fëmijëve të përgatitura nga Rrjeti Europian për Observatorët Kombëtarë mbi Fëmijët në 2008,<sup>5</sup>

<sup>2</sup>Holder, Y., Peden, M., Krug, E. et al (Eds). (2001). Injury surveillance guidelines. Geneva, World Health Organization.

<sup>3</sup>National Data Archive on Child Abuse and Neglect in collaboration with Walter R. McDonald & Associates, Inc. (2003). National Child Abuse and Neglect Data System (NANFDS) Detailed Case Data Component, 1998 – 1999: User's Guide and Codebook, New York.

<sup>4</sup>ICECI Coordination and Maintenance Group (2004). International Classification of External Causes of Injuries (ICECI) version 1.2. Consumer Safety Institute, Amsterdam and AIHW National Injury Surveillance Unit, Adelaide.

<sup>5</sup>Child Europe, European Network of National Observatories on Childhood (2008). Guidelines on Data Collection and Monitoring Systems on Child Abuse - Series 1.

- Raporti mbi Studimin e Incidencës së Raportuar të Abuzimit dhe Neglizhimit të Fëmijës në Kanada (2001),<sup>6</sup>
- Korniza konceptual dhe epidemiologjike për survejimin e keqtrajtimit të fëmijëve (2001),<sup>7</sup>
- Udhëzimet për raportimin dhe klasifikimin e abuzimit të fëmijëve të përdorura në shërbimet e kujdesit shëndetësor (1998),<sup>8</sup>

Dy kode që janë njësoj për të gjitha variablat janë:

"Tjetër" kodi = 88 (me hapësirë për komente) dhe

"i/e paspecifikuar" kodi = 99; Ky kod duhet përdorur në rastet kur mungon informacioni ndonëse përfaqësuesi i agjensisë ka treguar (gjatë plotësimit të Pjesës së Parë të Formës mbi karakteristikat e arkivit) që ky lloj informacioni zakonisht merret nga agjensia.

Në rastet kur agjensia nuk merr disa lloje të caktuara informacioni dhe prandaj nuk përfshihen në arkiv, atëherë duhet shënuar simboli në anën e djathtë lart për variablën "Nuk aplikohet".

Shënim: Kërkuesit duhet të jenë shumë të kujdesshëm që të mos e përdorin më shumë se ç'duhet variablën "i/e paspecifikuar" pasi kështu mund të humbasë informacion i rëndësishëm.

Komente

Komente dhe shënime të mëtejshme mund të vihen për çdo variabël ku kjo gjë kërkohet. Komentet mund të jenë:

- a. Udhëzime (p.sh. zgjedhje e shumëfishtë për të gjitha vlerat e mundshme të rastit)
- b. Shpjegim i vlerave (p.sh. "2=**Kujdestari ligjor**: Kujdestari ligjor është personi apo institucioni i deklaruar në testament ose i vendosur me urdhër gjykatë që do kujdeset për të miturit ose të rritur që nuk kujdesen dot për veten")
- c. Shënime (informacion i mëtejshëm për kërkuesin në lidhje me qëllimin e variablës)

<sup>6</sup> Trocmé, N., MacLaurin, B., Fallon, B. et al. (2001). Canadian Incidence Study of Reported Child Abuse and Neglect: Final Report. Ottawa, Ontario: Minister of Public Works and Government Services ANFada

<sup>7</sup> Wolfe, D. A., Yuan, L. (2001). A conceptual and epidemiological framework for child maltreatment surveillance. Ottawa: Minister of Public Works and Government Services Canada, Health Canada.

<sup>8</sup> Health ANFada (1998). Child Abuse: Reporting and Classification in Health Care Settings, Ottawa: Health Canada.

## Formati i Formave të Nxjerrjes së Informacionit

Që format e Nxjerrjes së Informacionit të jenë sa më lehtësisht të përdorueshme, janë përdorur një sërë kategorish specifike, të paraqitura në Tabelën e mëposhtme.

**Tabela 17: Karakteristikat e Formave**

- Kodimi me simbole**
- Dy simbolet e para përdoren për përgjigjet “nuk aplikohet” për karakteristikat e arkivit/database nga merret rasti. Të dy këto simbole përdoren vetëm në Formën për Rastet (Pjesa II).
  - Dy simbolet e tjera përdoren për të gjithë vlerat përveç rasteve kur një kërkohet një datë apo një numër si për shembull mosha e fëmijës.
- Ky simbol duhet shënuar në rastet kur një arkiv/database nuk përfshin informacion për një kategori të përgjithshme (për shembull, në lidhje me dhunuesin). Në këto raste, kërkuesi duhet të lërë pa plotësuar të gjitha variablat nën kategorinë në fjalë duke qene se nuk ka informacion për to.

Shembull:

**D. PERPETRATOR(S)-RELATED INFORMATION**

- Ky simbol duhet shënuar në rastet kur, megjithëse ka informacion për një kategori në arkiv/database, agjensia nuk mbledh informacion për një ose më shumë nga variablat e kësaj kategorie (për shembull, niveli i arsimit të prindërve). Në këto raste, kërkuesi duhet të shënojë simbolin në anën e djathtë lart që tregon që kjo variabël është e paaplikueshme.

Shembull:

H1: Previous maltreatment incidents ▼	
<input type="radio"/> 00	No (single incident)
<input type="checkbox"/> 01	Yes, substantiated maltreatment
<input type="checkbox"/> 02	Yes, indicated incident
<input type="checkbox"/> 88	Other
<input type="radio"/> 99	Unknown

- Ky simbol përdoret për të treguar se duhet zgjedhur vetëm **NJË** vlerat e variablës, pra që nuk variabla nuk mund të marrë më shumë se një vlerë (për shembull, do të ishte e pamundur që e njëjta variabël të merrte dhe vlerën "Po" dhe "Jo").

Shembull:

B2: Sex ▼	
<input type="radio"/> 01	Male
<input type="radio"/> 02	Female
<input type="radio"/> 99	Unknown

Në shumë variabla, ky simbol paraqitet së bashku me një simbol tjetër në formë katrori që tregon zgjedhje të shumëfishtë. Kjo do të thotë se informacioni që do të nxirret mund të ketë ose vlera të shumëfishta (treguar me simbolin katror) ose me një vlerë të vetme (treguar me simbolin rreth).

Shembull:

b4: Content of archive/database ▼	
<input type="checkbox"/> 01	Reported CAN cases
<input type="checkbox"/> 02	Detected CAN cases
<input type="checkbox"/> 03	Mixed (CAN & non-CAN cases)
<input type="checkbox"/> 88	Other
<input type="radio"/> 99	Unknown

Arkivi i mbajtur nga agjensia mund të përfshijë rastet e raportuara të ANF ose dhe lloje të tjera rastesh (p.sh një plagosje aksidentale që nuk ka lidhje me rastin). Në këtë rast kërkuesi duhet të zgjedhë vlerat 01 DHE 03 (simbolet katror). Në rastet kur përmbajtja e arkivit nuk dihet, atëherë kërkuesi duhet të zgjedhë kodin 99 (simbolin rreth) dhe asgjë tjetër. Nuk është e mundur që vlerat e një variable të jenë “e ditur” dhe “e panjohur” njëkohësisht.

- Ky simbol është përdorur për të indikuar faktin që një variabël specific mund të marrë më shumë se një vlerë (PËRZGJEDHJE e shumëfishtë)

Shëmbull:

B8: Substance-abuse problems ▼	
<input checked="" type="radio"/>	00 None
<input type="radio"/>	01 Drug abuse
<input type="radio"/>	02 Alcohol abuse
<input type="radio"/>	88 Other substances
<input type="radio"/>	99 Unknown

Siç është përmendur më lart, përzgjedhjet e shumëfishta përfshijnë VETËM vlerat e shoqëruara nga simboli "katror". Në shëmbull, kodet 01, 02 dhe 88 mund të validohen për një rast specific dhe për këtë arsye duhet të kontrollohen. Megjithatë nëse, janë selektohet si kodi 00 (asnjë) edhe 99 (I paspecificuar), atëherë, asnjë nga kodet 01, 02 dhe 88 janë vlera të vlefshme.

#### Kodimi me ngjyra

Katër ngjyra të ndryshme janë përdorur në formën e nxjerrjes së informacionit për të dhënat e kërkuara.

Ngjyra blu e errët tregon kategorinë e përgjithshme të cilës variabellet ndjekëse i përkasin.

Shëmbull:

D. PERPETRATOR(S)-RELATED INFORMATION	
---------------------------------------	--

Dy ngjyrat e mbetura tregojnë nëse plotësimi i variablës është i detyrueshëm ose i kushtëzuar, si më poshtë:

Plotësimi i detyrueshëm (*nëse është disponibël në arkivë*)

Shëmbull:

B2: Sex ▼	
<input checked="" type="radio"/>	01 Male
<input type="radio"/>	02 Female
<input type="radio"/>	99 Unknown

Plotësim i kushtëzuar (*nëse është disponibël në arkivë*)

C6: Physical Abuse Status ▶C5=1 ▼	
<input type="radio"/>	01 Substantiated
<input type="radio"/>	02 Indicated
<input type="radio"/>	03 Unsubstantiated
<input type="radio"/>	04 Closed no finding
<input type="radio"/>	88 Other
<input type="radio"/>	99 Unknown

Lidhur me këtë tip variabli, një shënim në fontin e kuq tregon vlerën e kërkuar në një variabël të mëparshëm i cili mundëson nxjerrjen e informacionit për një variabël të kushtëzuar.

C5: FORM OF MALTREATMENT ▼	
<input type="checkbox"/>	01 Physical Abuse
<input type="checkbox"/>	02 Sexual Abuse
<input type="checkbox"/>	03 Psychological Abuse
<input type="checkbox"/>	04 Neglect
<input type="checkbox"/>	88 Other form of maltreatment
<input type="checkbox"/>	99 Unknown

Në shëmbullin tonë (C6: Statusi i Abuzimit) variabli do të regjistrohet vetëm nëse vlera "1" është selektuar në variablin C5 (Forma e Keqtrajtimit); në ndonjë rast tjetër in any other case (nëse p.sh. "1" nuk është selektuar ose variabli C5 nuk është i aplikueshëm) atëherë variabli C6 do të shmanget.



## **Prezantimi i detajuar i variableve**

## PJESA I: Forma e nxjerrjes së informacionit nga Agjensitë & Arkivat

**Shënim i përgjithshëm:** Kjo formë do të kompletohet në bazë të përgjigjeve të përfaqësuesit të çdo agjensie që do të marrë pjesë në CBSS. Për këtë qëllim, forma më e përshtatshme për të mbledhur të dhënat e nevojshme është një intervistë e shkurtër e strukturuar që çdo kërkues duhet të zhvillojë me përfaqësuesin e Agjensisë.

Për të facilituar procesin për kërkuesit, pas "definimit" të çdo variabli individual një pyetje e dhënë (kur nevojitet) mund të përdoret nga kërkuesit për plotësimin e kësaj forme.

ID	a. Agjensia	Prezantimi i variablave																		
a1	<p><b>Variabla:</b></p> <p><b>Definicioni:</b></p> <p><b>Kategoria:</b></p> <p><b>Plotësimi:</b></p> <p><b>Kodimi:</b></p> <p><b>Matja:</b></p> <p><b>Shkalla Matëse:</b></p> <p><b>Vlerat koduese:</b></p> <p>99</p> <p><b>Komente:</b></p>	<p><b>Kodi Identifikues i Agjensisë</b></p> <p>Emërtimi unik i identifikimit të caktuar për çdo agjensie pjesëmarrëse në Studim</p> <p>Regjistrim informacioni relevant</p> <p>I detyrueshëm</p> <p>Fjalë</p> <p>Nominale</p> <p>9-Kodi shifror</p> <p>E paspecifikuar</p> <p>A. Kodi 9 shifror përbëhet nga dy gërmat e para të vendit + 4 gërma që për rajonin + 3 shifra ID për agjensinë e vendit (bazuar në listën e agjensive pjesëmarrëse në studim, shiko tabelën 4 deri në 12 në Protokoll)</p> <p>Shëmbull: GRATTI001=agjensia e parë (Instituti i Shëndetit të Fëmijës) nga rajoni i Atikës në Greqi</p> <p>Shënim: Duke pasur parasysh që Koordinatorët Kombëtarë e kanë në dispozicion listën e agjensive që do të përfshihen në CBSS (Shiko Protokollin, Tabelat 4.1 deri në 4.9), sugjerohet ky kod të plotësohet që në fillim me qëllim që të shmanget konfuzioni midis kërkuesve apo kodimi i dyfishtë.</p> <p>Shëmbull: Vendi-Greqi [GR]</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Lista e Agjensive</th> <th>Zona Gjeografike</th> <th>ID e Agjensisë</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Agjensia 1</td> <td>Atika</td> <td>GRATTI001</td> </tr> <tr> <td>Agjensia 2</td> <td>Atika</td> <td>GRATTI002</td> </tr> <tr> <td>Agjensia 3</td> <td>Maqedonia Qendrore</td> <td>GRMACE001</td> </tr> <tr> <td>Agjensia ...</td> <td>Kreta</td> <td>GRCRET001</td> </tr> <tr> <td>Agjensia n</td> <td>Kreta</td> <td>GRCRET002</td> </tr> </tbody> </table>	Lista e Agjensive	Zona Gjeografike	ID e Agjensisë	Agjensia 1	Atika	GRATTI001	Agjensia 2	Atika	GRATTI002	Agjensia 3	Maqedonia Qendrore	GRMACE001	Agjensia ...	Kreta	GRCRET001	Agjensia n	Kreta	GRCRET002
Lista e Agjensive	Zona Gjeografike	ID e Agjensisë																		
Agjensia 1	Atika	GRATTI001																		
Agjensia 2	Atika	GRATTI002																		
Agjensia 3	Maqedonia Qendrore	GRMACE001																		
Agjensia ...	Kreta	GRCRET001																		
Agjensia n	Kreta	GRCRET002																		
a2	<p><b>Variabla:</b></p> <p><b>Definicioni:</b></p> <p><b>Pyetja e sugjeruar:</b></p> <p><b>Kategoria:</b></p> <p><b>Plotësimi:</b></p> <p><b>Kodimi:</b></p> <p><b>Shkalla Matëse:</b></p> <p><b>Vlerat koduese:</b></p> <p>1</p> <p>2</p> <p>3</p> <p>4</p> <p>5</p> <p>88</p> <p>99</p> <p><b>Komente:</b></p>	<p><b>Statusi Legal</b></p> <p>Statusi ligjor i Agjensisë</p> <p>"Cili është statusi ligjor i organizatës tuaj?" [Jep alternativat]</p> <p>Informacioni për Agjensinë</p> <p>I detyrueshëm</p> <p>Numerik</p> <p>Nominale</p> <p>Vlera</p> <p>Organizatë jo Fitimprurëse - NGO</p> <p>Agjensie gjysëm publike</p> <p>Organizatë Publike Rajonale</p> <p>Organizatë e Qeverisë Qendrore</p> <p>Autoritet i Pavarur (si p.sh. Ombudsmani i Fëmijëve)</p> <p>Tjetër</p> <p>E paspecifikuar</p> <p>A. Shpjegimi i vlerave:</p> <p>1. Organizatë Jo Fitimprurëse NGO: Që të konsiderohet si Organizatë Jo</p>																		

		<p>Fitimprurëse, një organizatë duhet të pavarur nga kontrolli i qeverisë, jo fitimprurëse, të mos konsiderohet parti politike dhe të mos jetë e përfshirë në aktivitete kriminale.</p> <p>2. Agjensi gjysëm publike: Mund të jetë një subjekt privat në pronësi apo e sponsorizuar rregullisht në përputhje me dispozitat e aplikueshme të fondeve shtetërore të buxhetit vjetor ose një ndërmarrje publike ose një institucion publik</p> <p>3. Organizatë Publike Rajonale: Një organizatë që i përket një Qeverisje locale/rajonale (e aplikueshme për vendet me qeveri vendore të decentralizuara)</p> <p>4. Organizatë e Qeverisë Qendrore: Një organizatë që i përket strukturës së qeverisë qendrore nën një Departament specifik apo Ministri.</p> <p>5. Autoritet i pavarur: Një autoritet i pavarur i një niveli ekzekutiv/rekomandues, si Ombusmani, që ka në vëmendje respektimin e mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve.</p> <p>88. Tjetër 99. E paspecifikuar</p> <p>Shënim: Të adoptohet sipas specifikave të çdo vendi</p>
